



Instalimi i shërbimit COBISS IO



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

Regional Centre for
Library Information Systems and
Current Research Information Systems
Regionalni center za knjižnične
informacijske sisteme in informacijske
sisteme o raziskovalni dejavnosti

IZUM

© IZUM, 2025

IZUM, COBISS, COMARC, COBIB, COLIB, CONOR, SICRIS, E-CRIS, COBISS3, mCOBISS, COBISS+, dCOBISS, COBISS4, SGC, COBISS Lib, COBISS Cat, COBISS Ela janë marka të regjistruara në pronësi të institucionit publik IZUM.

KAZALO VSEBINE

1	Hyrje	4
2	Instalimi i aplikacionit OpenWebStart	4
3	Instalimi i aplikacionit COBISS IO.....	8
3.1	Gabimet gjatë hapjes së aplikacionit COBISS IO.....	12
	COBISS DGW ende funksionon.....	12
	COBISS IO nuk hapet në mënyrë automatike	13
	Largimi i shërbimit COBISS DGW	13
4	Parametrat në aplikacionin COBISS IO	15
	Përshkrimi i parametrave për aplikacionin COBISS IO	16
4.1	Parametrat RFID	17
	Setup Holdings	18
	Setup Patrons.....	20
	Book Common List.....	21
	Book List.....	22
	Book Editor	23
	Patron Editor	24
	Instalimi i driverit USB për librat RFID	25
	Instalimi i driverit për pajisjen RFID për leximin e kartave të anëtarësisë.....	25
	Njoftimi i IZUM-it dhe konfirmimi i funksionimit	25
4.2	POS	25
4.3	DGW LOG Editor	26

FIGURAT

Figura 1: Transferimi i aplikacionit OpenwebStart	4
Figura 2: Dritarja fillestare e instalimit.....	5
Figura 3: Kushtet e licencës	5
Figura 4: Instalimi pa privilegjet e administratorit	6
Figura 5: Instalimi me privilegjet e administratorit	6
Figura 6: Përzgjedhja e vendndodhjes së instalimit.....	7
Figura 7: Shoqërimet e skedarëve	7
Figura 8: Përfundimi i instalimit	8
Figura 9: Transferimi në mënyrë automatike i programit Java.....	8
Figura 10: Konfirmimi i sigurisë	9
Figura 11: Instalimi i shkurtores	9
Figura 12: Shënimi i akronimit të bibliotekës.....	9
Figura 13: Shkurtorja	10
Figura 14: COBISS IO	10
Figura 15: Hapja në mënyrë automatike e aplikacionit COBISS IO	11
Figura 16: System tray	11
Figura 17: System tray – hap/mbyll.....	12
Figura 18: DGW ende funksionon	12
Figura 19: Largimi i COBISS DGW.....	13
Figura 20: Command Prompt – CMD.....	14
Figura 21: Fshirja e shërbimit Cobiss3JettyService.....	14
Figura 22: COBISS IO Properties.....	15
Figura 23: RFID	17
Figura 24: Rregullimi i parametrave	18
Figura 25: Parametrat e pllakës RFID për materialin, të lidhur përmes USB	19
Figura 26: Parametrat TCP/IP për pllakën RFID për materialin – driver	19
Figura 27: Parametrat e TCP/IP për pllakën RFID për materialin – COBISS DGW	20
Figura 28: Parametrat e pllakës RFID për kartën e anëtarësisë	21
Figura 29: Shfaqja e listës së materialeve në pllakën RFID për materialin	22
Figura 30: Shfaqja e listë së materialeve në pllakën RFID për materialin	23

Figura 31: Book Editor (materialët).....	24
Figura 32: Patron Editor (anëtarët).....	24
Figura 34: Parametrat e terminalit POS për COBISS Lib.....	26
Slika 36: DGW LOG Editor.....	27

1 Hyrje

Në dokument është përshkruar procedura e instalimit të aplikacionit COBISS IO, i cili zëvendëson shërbimin COBISS DGW. Nëse ky i fundit tashmë është i instaluar bllokojeni atë ose largojeni sipas udhëzimeve në kapitullin [3.1 Gabimet gjatë hapjes së aplikacionit COBISS IO](#). Ky aplikacion është i nevojshëm për funksionimin e pajisjeve RFID, në COBISS Lib për funksionimin e shumicës së pajisjeve periferike (p.sh. printerëve, sirtarit të arkës...) dhe disa funksione të tjera p.sh. instalimi i certifikatit për arkën tatimore, VALÚ etj. Se kur është i domosdoshëm instalimi i COBISS IO është shpjeguar në: <https://www.cobiss.net/help/sq/general/general.html>.

KUJDES: Për instalimin e aplikacionit COBISS IO fillimisht duhet të instaloni aplikacionin [OpenWebStart](#).

2 Instalimi i aplikacionit OpenWebStart

Aplikacioni OpenWebStart zëvendëson programin Java. Kur të hapni programin, ju kërkohen të drejtat e administratorit në kompjuter. Programin OpenWebStart për Windows 64-bite e shkarkoni nga faqja elektronike <https://openwebstart.com/download/>.




Figura 1: Transferimi i aplikacionit OpenwebStart

Gjatë hapjes së programit shfaqet dritarja në figurën poshtë. Shtypni butonin **Next**.




Figura 2: Dritarja fillestare e instalimit

Konfirmoni dhe pranoi kushtet e licencës (I accept the agreement).




Figura 3: Kushtet e licencës

Nëse nuk keni privilegjet e administratorit dhe ju jeni përdoruesi i vetëm i COBISS Lib në kompjuterin lokal, lërimi vlerat e paracaktuara dhe vazhdoni me **Next**.




Figura 4: Instalimi pa privilegjet e administratorit

Nëse keni privilegjet e administratorit, aplikacionin mund ta instaloni për të gjithë përdoruesit në kompjuter. Pasi të përzgjidhni këtë mundësi klikoni **Next**.




Figura 5: Instalimi me privilegjet e administratorit

Instalimin e vazhdoni duke shtypur butonin **Next**.




Figura 6: Përzgjedhja e vendndodhjes së instalimit




Figura 7: Shoqërimet e skedarëve

Instalimin e përfundoni duke shtypur butonin **Finish**.




Figura 8: Përfundimi i instalimit

3 Instalimi i aplikacionit COBISS IO

Nga linku [COBISS IO](#) transferoni aplikacionin COBISS IO. Aplikacionin e gjeni tek shkarkimet (downloads) dhe filloni instalimin e tij.

Pas fillimit të instalimit shfaqet dritarja që shihni më poshtë, ndërsa në mënyrë automatike transferohet programi Java, i cili është i nevojshëm për funksionimin e COBISS IO.




Figura 9: Transferimi në mënyrë automatike i programit Java

Pyetjen e sigurisë e konfirmoni duke klikuar **Run**.




Figura 10: Konfirmimi i sigurisë

Asistenti ju pyet nëse dëshironi të instaloni shkurtoresh në desktop. Konfirmoni me **OK**.




Figura 11: Instalimi i shkurtores

Shënoni akronimin e bibliotekës (p.sh. IZUM).




Figura 12: Shënimi i akronimit të bibliotekës

Në desktop krijohet shkurtoresh COBISS IO.



Figura 13: Shkurtorja

Hapet COBISS IO.




Figura 14: COBISS IO

Rekomandohet që të klikoni kutinë e zgjedhjes **Start CIO after login**. Me këtë veprim aplikacioni hapet në mënyrë automatike pasi të hapni kompjuterin. Nëse dëshironi që hapjen automatike ta pamundësoni, mos e klikoni kutinë e zgjedhjes **Start SIO after login**.




Figura 15: Hapja në mënyrë automatike e aplikacionit COBISS IO

Aplikacioni shfaqet në desktop vetëm në fillim, pas instalimit. Më pas aplikacioni fshehet në sfond dhe atë mund ta gjeni në **system tray**.




Figura 16: System tray

Nëse klikoni në tastin e djathtë të miut shfaqen tri mundësi. Me **Open** hapni aplikacionin, me **Closed** atë e fshehni nga desktopi, ndërsa me **Exit** aplikacionin e mbyllni.




Figura 17: System tray – hap/mbyll

Nëse në aplikacionin COBISS Lib nga pajisjet periferike përdorni vetëm printerët ose tabelën për nënshkrim, për ju procedura e instalimit ka përfunduar. Për instalimin RFID të pajisjeve, funksioneve shtesë p.sh. instalimi i certifikatit për arkën tatimore, VALÚ etj. duhet të rregulloni edhe parametrat sipas kapitullit [4 Parametrat në aplikacionin COBISS IO](#).

3.1 Gabimet gjatë hapjes së aplikacionit COBISS IO

COBISS DGW ende funksionon

Gjatë hapjes së COBISS IO mund të ndodhë ky gabim:



Figura 18: DGW ende funksionon

Kjo do të thotë se DGW ende funksionon. Në këtë rast **në Services** duhet ta çaktivizoni shërbimin **Cobiss3JettyService** (Startup type vendoseni në **Disabled**).

COBISS IO nuk hapet në mënyrë automatike

Pavarësisht klikimit të kutisë së zgjedhjes në **Start CIO after login**, COBISS IO nuk hapet në mënyrë automatike sapo të hapni kompjuterin. Mesiguri problemi qëndron në faktin se aplikacioni nuk ka shtuar shkurtoren midis aplikacioneve që hapen në mënyrë automatike.

1. Me anë të tastit të djathtë të miut klikoni menunë Start  dhe përzgjidhni »Run«.
2. Në **dritaren për dialog** Run, vendosni **shell:startup** ose **shell:common startup** dhe përzgjidhni **Enter**. Shfaqet dritarja me listën e aplikacioneve që hapen në mënyrë automatike, kur përdoruesi regjistrohet.
3. Tërhiqeni dhe lëshojeni (drag and drop) shkurtoren COBISS IO nga desktopi në këtë dritare. Nëse dëshironi të largoni programet nga dosja e nisjes (startup), fshini linqet (shortcuts) nga kjo dritare. Pasi të ristartoni kompjuterin, COBISS IO duhet të hapet në mënyrë automatike.

Largimi i shërbimit COBISS DGW

Kur të keni verifikuar funksionimin e të gjitha pajisjeve periferike dhe shërbimeve me COBISS IO, shërbimin COBISS DGW mund ta largoni sipas kësaj procedure:

Në Control Panel, Programs dhe Programs and Features largoni programin **Cobiss Device Gateway Service**.




Figura 19: Largimi i COBISS DGW

Pastaj hapni Command Prompt – CMD si administrator.




Figura 20: Command Prompt – CMD

Shënoni komandën: **sc delete Cobiss3JettyService**.

Nëse largimi bëhet me sukses, programi ju njofton: [SC] DeleteService SUCCESS.




Figura 21: Fshirja e shërbimit Cobiss3JettyService

4 Parametrat në aplikacionin COBISS IO

Në aplikacionin COBISS IO mund të redaktoni parametrat për të gjitha modulet e vendosura në COBISS IO Properties.




Figura 22: COBISS IO Properties

- **COBISS IO:** shfaqet versioni COBISS IO dhe versioni i programit Java.
- **COBISS IO Properties:** Shfaqen të dhënat për parametrat bazë RFID dhe serverin DMS. Parametrat rregullohen në skedarin *Dgw.cfg* në dosjen *C:\Cobiss3Files\conf*.
- **COBISS IO SIP Properties:** Shfaqen parametrat për serverin SIP, i cili përdoret nga p.sh. libromati, klasifikuesi etj. Të dhënat përdoren për lidhje të sigurt VPN. Parametrat rregullohen në skedarin *Dgw.cfg* në dosjen *C:\Cobiss3Files\conf*. Butoni **Manual Run** përdoret për ekzekutimin në mënyrë manuale të komandës PLINK. Butoni **Test SIP2** verifikon ekzistencën e lidhjes SIP. Testimi i suksesshëm kthen mesazhin *loginresponse false*. Butoni **Check Plink Process** kontrollon nëse në sfond po zhvillohet procesi Plink.exe. **Kill Plink Process** anulohet procesi i caktuar *Plink.exe*.
- **RFID:** Në këtë modul rregullohen parametrat e pajisjeve të veçanta RFID, p.sh. lexuesi RFID për materialet, lexuesi RFID për anëtarët etj.
 - **Setup Holdings:** Parametrat e lexuesit RFID për materialet.
 - **Setup Patrons:** Parametrat e lexuesit RFID për anëtarët.
 - **Book Common List:** Shfaqen të gjithë çipat RFID, të cilët ndodhen në lexuesin RFID për materialet. Shfaqet edhe tek metodat e ndryshme nga COBISS Lib, kur është e nevojshme vendosja në mënyrë manuale e mbrojtjes së materialit.

- **Book List:** Shfaqen të gjithë çipat RFID, të cilët ndodhen në lexuesin RFID për materialin. Përdoret vetëm në driverin e IZUM-it.
- **Book Editor:** Mund të shënoni ose redaktoni të dhënat në çipin RFID për materialin. Përdoret vetëm në driverin e IZUM-it.
- **Patron Editor:** Shfaqen të dhënat e regjistruara në çipin RFID në kartën e anëtarit.
- **SIMULATOR:** Përdoret nga zhvilluesit e programeve për rregullimin e parametrave në pajisjet periferike.
- **FURS:** Është moduli për rregullimin e parametrave për vërtetimin tatimor të faturave në Republikën e Sllovenisë.
- **POS:** Moduli për rregullimin e parametrave për terminalin POS për përdorimin e COBISS Lib.
- **Valu:** Në këtë modul rregullohen parametrat VALU.

Përshkrimi i parametrave për aplikacionin COBISS IO

Në dosjen *C:\Cobiss3Files\conf* ndodhet skedari *Dgw.cfg*. Në të ndodhen parametrat, që duhet të rregullohen për aplikacionin COBISS IO.

Parametrat:

- **PERIOD_DGW** – Me këtë parametër përcaktohet intervali i dërgimit të njoftimeve në server. Njësia bazë është sekondi. Vlera e paracaktuar është 900 (sekonda).
- **LOGGING_LEVEL** – Vlera duhet të jetë *ALL*, përcakton nivelin e regjistrimit.
- **ACRONYM_DGW** – Këtu vendosni akronimin e bibliotekës. Është e dhënë shumë e rëndësishme.
- **DMS_SERVER_ADDRESS** – Shënoni titullin për serverin dms. Vlera e paracaktuar është *ws.cobiss.net*.
- **DMS_SERVER_PORT** – Porta, në të cilën dëgjon serveri dms. Vlera e paracaktuar është 443.
- **DMS_SERVER_SSL** – Vlera e paracaktuar duhet të jetë *true*.

Serveri dms ka për detyrë të regjistroj dhe të shfaq statusin e shërbimit dgw. Aplikacioni COBISS IO lidhet në serverin dms, ku regjistrohet gjendja e aplikacionit. Në këtë mënyrë ndiqet më lehtë funksionimi i ndërfaqeve periferike.

4.1 Parametrat RFID

Inventarizimi RFID për zgjidhjet e IZUM-it është përshkruar në udhëzime ose në manual të veçantë. Për zgjidhjet e IZUM-it (IzumHoldingFeigReader) regjistrimi i të dhënave në çipin RFID është bërë sipas standardit danez:

http://biblstandard.dk/rfid/dk/rfid_data_model_for_libraries_february_2009.pdf.

Përkrah zgjidhjeve të IZUM-it ekziston edhe zgjidhja përmes driverave dedikues si dhe zgjidhja përmes RFID_REST_Interface, e cila është më e re në krahasim me dy mundësitë e mësipërme.

Në modulën RFID vendosni parametrat për serverat. Fillimisht duhet të vendosni dy ndërfaqe fizike: Setup Holdings – lexuesi i etiketave për materialin, Setup Patrons – lexuesi i kartave të anëtarëve.




Figura 23: RFID

Për shtimin e pajisjes së re RFID në kompjuterin lokal duhet të rregulloni parametrat. Nën RFID për zgjidhjet e pajisjes, për të cilën dëshironi të rregulloni parametrat dhe të shtypni **Edit**.




Figura 24: Rregullimi i parametrave

Setup Holdings

Në dritaren **Holding RFID** për zgjidhni **Enabled: Yes**. Nëse përdorni zgjidhjet e IZUM-it, për zgjidhni **Type/Model: IzumHoldingFeigReader**. Zgjidhjet e tjera i për zgjidhni nga lista. Për mënyrën e lidhjes mund të për zgjidhni midis USB, TCP/IP ose Serial.




Figura 25: Parametrat e pllakës RFID për materialin e lidhur përmes USB

Nëse përzgjidhni TCP/IP, keni *FEDiscO.exe* në dosjen *C:\Cobiss3Files\bin\V0.9.0*, me anë të të cilit mund të kontrolloni adresën IP të pajisjes RFID. Më pas këtë adresë IP e shënoni në fushën Address.




Figura 26: Parametrat TCP/IP për pllakën RFID për materialin – driver




Figura 27: Parametrat e TCP/IP për pllakën RFID për materialin – COBISS DGW

Setup Patrons

Në dritaren **Patron RFID** përzgjidhni **Enabled: Yes**. Nëse përdorni zgjidhjet e IZUM-it, përzgjidhni **Type/Model: IzumPatronFeigReader**. Zgjidhjet e tjera i përzgjidhni nga lista. Për mënyrën e lidhjes mund të përzgjidhni midis USB, TCP/IP ose Serial.




Figura 28: Parametrat e pllakës RFID për kartën e anëtarësisë

Book Common List

Në dritaren **Common List RFID items** mund të lexoni çipat RFID, të cilët janë në pllakën RFID për materialin. Leximi i etiketës RFID do të funksionoj pas konfirmimit të pajisjes në IZUM (shih Njoftimet IZUM dhe konfirmimi i funksionimit). Në të njëjtën mënyrë në kolonën **Change EAS tag** mund të përfshini ose të largoni mbrojtjen e materialit duke klikuar kutinë e zgjedhjes dhe butonin **Change**. Përmes **Start refresh** mund të vendosni freskimin automatik të leximit të etiketave RFID.




Figura 29: Shfaqja e listës së materialeve në pllakën RFID për materialin

Book List

Në dritaren **List RFID items** mund lexoni çipat RFID të cilët janë në pllakën RFID për materialin. Format i në të cilin shfaqen rezultatet është ai danez S24/u4 ('mandatory part'). Dritarja është aktive vetëm për zgjidhjet e IZUM-it. Leximi i etiketave RFID do të funksionoj pas konfirmimit të pajisjes në IZUM (shih Njoftimet IZUM dhe konfirmimi i funksionimit). Gjithashtu në kolonën **EAS tag** mund të përfshini/largoni mbrojtjen e materialit. Përmes **Start refresh** mund të vendosni freskimin automatik të leximit të etiketave RFID.




Figura 30: Shfaqja e listë së materialeve në pllakën RFID për materialin

Book Editor

Në dritaren **RFID item** mund të lexoni dhe të regjistroni të dhënat në çipin RFID për materialin. Të gjitha të dhënat regjistrohen në formatin danez S24/u4 ('mandatory part'). Dritarja është aktive vetëm për zgjidhjet e IZUM-it. Dritarja nuk përdoret për inventarizimin ose veprimet e tjera, por përdoret kryesisht për qëllime testuese.




Figura 31: Book Editor (materialët)

Patron Editor

Në dritaren **Patron RFID** mund të lexoni të dhënat në çipin RFID për kartën e anëtarësisë.




Figura 32: Patron Editor (anëtarët)

Instalimi i driverit USB për librat RFID

Në dosjen *C:\Cobiss3Files\bin* ndodhet dosja *Standard_USB_Driver_v03.10.00*. Në të i gjeni udhëzimet për instalimin e driverit USB. Instalimi i driverit fillon me hapjen e skedarit *setup.exe*. Programi për instalim ju udhëzon përgjatë gjithë procedurës së instalimit. Mund të përdorni edhe driverët e fundit të shkarkuar nga faqja elektronike FEIG ose driverët e pranuar bashkë me pajisjen.

Instalimi i driverit për pajisjen RFID për leximin e kartave të anëtarësisë

Në dosjen *C:\Cobiss3Files\bin* ndodhet dosja *Setup_CDC_V184_Build20130214*. Në të i gjeni udhëzimet për instalimin e driverit CDC USB për ndërfaqen FEIG ID RW40.30-USB. Instalimi fillon me hapjen e skedarit *setup.exe*. Programi për instalim ju udhëzon përgjatë gjithë procedurës së instalimit. Mund të përdorni edhe driverët e fundit të shkarkuar nga faqja elektronike FEIG ose driverët e pranuar bashkë me pajisjen.

Njoftimi i IZUM-it dhe konfirmimi i funksionimit

Që një pllakë RFID të funksionoj në COBISS Lib pajisjen duhet fillimisht ta konfirmoni në IZUM. Më së miri është të thirrni në qendrën për thirrje të IZUM-it, në numrin e telefonit **+386 (2) 2520 333** ose të njoftoni me shkrim IZUM-in në adresën elektronike podpora@izum.si. Do të njoftoheni me shkrim ose përmes telefonit kur IZUM-i të mundësoj përdorimin e saj.

4.2 POS

Për përdorimin e terminalit POS në COBISS Lib përzgjidhni **Enabled: Yes** në modulën POS, modelin e përshtatshëm dhe metodën e lidhjes. Gjithashtu vendosni vlerat e duhura për lidhjen e përzgjedhur, p.sh. adresën IP, portën etj. Kopjoni atë nga terminali POS.





Figura 33: Parametrat e terminalit POS për COBISS Lib

4.3 DGW LOG Editor

Në modulën DGW LOG Editor mund të kontrolloni funksionimin në tërësi të COBISS IO. Në rast se paraqiten probleme në COBISS Lib ju mund të kopjoni përmbajtjen e skedarit log dhe bashkë me përshkrimin e gabimit ta dërgoni në adresën elektronike podpora@izum.si. Skedarët log (Log files) ndodhen edhe në dosjen C:\Cobiss3Files\log.



Slika 34: DGW LOG Editor